



Pranimar / Dorezuar Prijmjeno / Predato Received / Delivered	26.06.2023	3	viti god year
Organ / Objekta Org / Objekt	Nr Prot Br Prot Prot No	Shifra Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRINSHOCK	4915/2023		119



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.764/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë \_\_\_\_\_ të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat \_\_\_\_\_ me adresë rruga "Fehmi Agani", Hyrja 154, Kati I, Nr. 8 në Komunë të Prishtinës, kundër Vendimit me Nr. ref: 160/2023 të datës 03.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Masë disiplinore-largim nga shërbimi civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 26.06.2023, mori këtë:

### V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa më numër A.nr.764/2023 e datës 19.05.2023 e parashtruar nga ankues.

II. Ndryshohet Vendimi me Nr. ref: 160/2023 i datës 03.05.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit ashtu që masa disiplinore "Largim nga shërbimi civil" ndryshohet në masën disiplinore "Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë për dy vjet",

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës në pozitën Zyrtar i Lartë për Politika të NATO-së sipas Akt Emërimit AE.Nr.46/2022 të datës 13.06.2022 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me marrëdhënien e punës, duke bërë kompensimin e të gjitha pagave nga dita e pezullimit të marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

**IV. Obligohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Jashtme që ankuesit t'i heq nga dosja personale masën disiplinore "*Largim nga shërbimi civil*" ndërsa në dosjen personale të vendosë masën disiplinore "*Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë për dy vjet*".

**V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi [ ] i punësuar sipas Akt Emërimit AE.Nr.46/2022 të datës 13.06.2022 është i punësuar në pozitën *Zyrtar i Lartë për Politika të NATO-së*, sipas Vendimit me Nr.Ref:360/2020 të datës 24.10.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është caktuar kryesues i grupit ndërinstitutional për koordinimin e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 20.03.2023 ka paraqitur kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit pranë Komisionit Disiplinorë për shkak: 1. *Mos kryerjes së detyrave dhe përgjegjësiwe sipas vendimeve me Nr. Ref: 4447 të datës 24.10.2022*; 2. *Mos zbatim i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale*; 3. *Shkelje e detyrimeve të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë*; 4. *Shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etike duke mos respektuar orarin e punës*.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 18.04.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.Ref:118/2023 përmes të cilit ka bërë shtyrjen e afatit të procedurës administrative deri më datë 03.05.2023 për shkak të kompleksitetit të lëndës, ndërsa sipas Vendimit me Nr.ref:88/2023 të datës 20.03.2023 ka bërë pezullimin e marrëdhënies së punës së ankuesit deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 03.05.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.ref:160/2023 përmes të cilit ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore *Largim nga shërbimi civil*.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.ref:160/2023 të datës 03.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 19.05.2023 ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin për shkelje procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.05.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e

ankueses nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 26.05.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 4356/2023 e datës 19.05.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 03.05.2023 nga ankuesi për A.M; Emailin e datës 03.05.2023 nga A.M për ankuesin; Raporti javor për periudhën 05-09.12.2022 nga ankuesi; Raporti javor për periudhën 01.04.2022 nga ankuesi; Raporti javor për periudhën 03-07.10.2022 nga ankuesi; Raporti javor për periudhën 31.01.2023 deri më datë 03.02.2023 nga ankuesi; Raporti javor për periudhën 06-10.03.2023 nga ankuesi; Raporti javor për periudhën 19-23.12.2022 nga ankuesi; Raporti javor për periudhën 23-27.01.2023 nga ankuesi; Akt Emërimin me numër të aktit 082 të datës 21.02.2013; Listën e vijueshmërisë në punë për ankuesin për periudhën janar-shkurt 2023; Autorizimin e datës 22.03.2023; Emailin e datës 31.01.2023 nga B.I për ankuesin; Emailin e datës 26.01.2023 nga C.C për Sh.J dhe M.P; Emailin e datës 26.01.2023 nga Sh.J për C.C dhe M.P; Emailin e datës 07.03.2023 nga B.I për A.M; Emailin e datës 03.03.2023 nga ankuesi për B.I; Emailin e datës 01.02.2023 nga B.I për ankuesin; Emailin e datës 01.02.2023 nga ankuesi për B.I; Vendimin me Nr. Ref: 360/2022 i datës 24.10.2022; Emailin e datës 06.03.2023 nga ankuesi për B.H; Emailin e datës 06.03.2023 nga B.H për ankuesin; Emailin e datës 20.03.2023 nga ankuesi për B.I; Emailin e datës 20.03.2023 nga B.I për ankuesin; Emailin e datës 08.03.2023 nga B.M për ankuesin; Emailin e datës 08.03.2023 nga ankuesi për B.M; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore e datës 20.03.2023; Vendimin me Nr. ref: 88/202 i datës 20.03.2023 i Komisionit Disiplinor; Vendimin me Nr.ref:160/2023 të datës 03.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 24.05.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 26.05.2023; Akt Emërimin AE.Nr.46/2022 i datës 13.06.2022; Emailin e datës 20.03.2023 nga Burimeve Njerëzore MPJD për ankuesin; Emailin e datës 20.03.2023 nga Burimeve Njerëzore MPJD për B.B, H.B dhe K.K; Vendimin me Nr. ref: 118/2023 i datës 18.04.2023 i Komisionit Disiplinor; Emailin e datës 31.03.2023 nga B.B për Burimet Njerëzore MPJD; Emailin e datës 31.03.2023 nga Burimet Njerëzore MPJD për B.I; Emailin e datës 31.03.2023, 13.04.2023, 14.04.2023, 18.04.2023 nga Burimet Njerëzore MPJD për ankuesin; Emailin e datës 17.04.2023 nga ankuesi për Burimeve Njerëzore në MPJD; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 13.04.2023, 18.04.2023; Vërejtjen me Nr. Ref: 11/2023 e datës 23.01.2023 e shqiptuar ndaj ankuesit; Emailin e datës 02.05.2023 nga B.B për K.K dhe H.B; Emailin e datës 26.04.2023 nga B.P për B.I; Emailin e datës 18.04.2023 nga A.Ll për B.I; Emailin e datës 31.03.2023 nga B.I për A.Ll; Emailin e datës 19.04.2023 nga Burimeve Njerëzore MPJD për B.B, H.B dhe K.K; Shkresë e datës 23.02.2023 dhe 26.10.2022; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 02.05.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve ne punë për ankuesin i datës 31.01.2023, 01.11.2021; Vendimin A.nr.402/2023 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit, është pjesërisht e bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.ref:160/2023 të datës 03.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shqiptimin e masës disiplinore *"largim nga shërbimit civil"*, pretendon se iniciimi i procedurës disiplinore është bërë nga personi jo kompetent ngase Sekretari i Përgjithshëm nuk është udhëheqës i drejtpërdrejtë i tij; Komisioni Disiplinor ka vendosur jashtë afatit prej 30 ditësh për shkak se procedura disiplinore është inicuar më datë 20.03.2023 dhe nuk është ndërmarr asnjë veprim lidhur me trajtimin e çështjes deri më datë 18.04.2023, ndërsa shtyrja e afatit për vendosje nga ana e këtij komisioni është veprim për të mbuluar dështimin e shqyrtimit të rastit brenda afateve ligjore; Komisioni Disiplinor gabimisht ka konstatuar që nuk janë përmbushur detyrat e përcaktuara me vendimin e datës 24.10.2022 për shkak se kam përmbushur të gjitha detyrat e përcaktuara sipas këtij vendimi; Mos respektimi i orarit të punës nuk është shkelje e rëndë disiplinore por është shkelje e lehtë, si rrjedhojë Komisioni Disiplinor nuk ka pasur kompetencë të shqyrtoj këtë pretendim të inicuesit; kështu që nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shqiptimin e kësaj mase sepse nuk janë plotësuar elementet e përgjegjësisë disiplinore.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi është i punësuar në kuadër të Divizionit për Evropë dhe BE në Departamentin për Evropë, BE dhe Rajon, ku sipas konfirmimit përmes emailit të datës 20.06.2023 është konfirmuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës se pozita e Drejtorit të Departamentit për Evropë, BE dhe Rajon është e lirë nga data 07.12.2022, ndërsa pozita e Udhëheqësit të Divizionit për Evropë dhe BE është e lirë nga data 01.02.2022, rrjedhimisht të njëjtat janë të pa plotësuara. Andaj lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se iniciimi i procedurës disiplinore është bërë nga personi jo kompetent ngase Sekretari i Përgjithshëm nuk është udhëheqës i drejtpërdrejtë i tij, Kolegji i Këshillit, konstaton se referuar nenit 18 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, i cili ka përcaktuar se: *"3. Sekretari i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi kryesore: 3.1. mbështet ministrin në punën e tij; 3.2. siguron koordinimin e hartimit të politikave në ministrinë përkatëse; 3.3. siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit, të politikave dhe të vendimeve të ministrit; 3.4. siguron drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit ministror; 3.5. siguron bashkëpunimin me ministri të tjera dhe institucionet, si dhe me agjencitë e pavarura; 3.6. vendos për administrimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, të sistemit ministror, në përputhje me legjislacionin në fuqi; 3.7. çdo përgjegjësi tjetër, që i caktohet me ligj apo të deleguar shprehimisht nga ministri"*, ngase për kohën kur ndaj ankuesit është inicuar procedura disiplinore pozita e Drejtorit të Departamentit për Evropë, BE dhe Rajon dhe Udhëheqësit të Divizionit për Evropë dhe BE kanë qenë të lira dhe nuk ka qenë ndonjë nëpunës civil duke i ushtruar këto pozita, rrjedhimisht në këtë rast për nga hierarkia mbikëqyrës i drejtpërdrejtë ka qenë Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm. Po ashtu referuar dispozitave të nenit 48 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë është përcaktuar se: *"4. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.1. me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil; 4.2. me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, si dhe me kërkesën e qytetarit; 4.3. me nismën e çdo anëtari të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një*

*shkeljeje disiplinore*”, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e lartcekura, kështu që ky pretendim i ankuesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se, Komisioni Disiplinor ka vendosur jashtë afatit prej 30 ditësh për shkak se procedura disiplinore është iniciuar më datë 20.03.2023 dhe nuk është ndërmarr asnjë veprim lidhur me trajtimin e çështjes deri më datë 18.04.2023, ndërsa shtyrja e afatit për vendosje nga ana e këtij komisioni është veprim për të mbuluar dështimin e shqyrtimit të rastit brenda afateve ligjore, Kolegji i Këshillit, në mënyrë të hollësishme ka shqyrtuar të gjitha provat materiale të lëndës dhe pas administrimit të tyre, ka ardhur në përfundim se ky pretendim është i pabazuar, ngase inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë në Njësinë e Burimeve Njerëzore më datë 20.03.2023 nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kurse ankuesi më datë 20.03.2023 është njoftuar përmes emailit nga Burimet Njerëzore të MPJD për iniciimin e kësaj procedure. Ankuesi më datë 31.03.2023 përmes emailit është njoftuar nga Burimet Njerëzore të MPJD se seanca e komisionit disiplinor është caktuar të mbahet më datë 14.04.2023 nga ora 10:00, ndërsa për të njëjtën çështje ankuesi është rikujtuar më datë 13.04.2023 përmes emailit nga Burimet Njerëzore të MPJD, mirëpo Burimet Njerëzore të MPJD-së më datë 14.04.2023 kanë njoftuar ankuesin se pas mos paraqitjes në seancë i është dhënë mundësia të paraqitet në një seancë më datë 18.04.2023 prej orës 11:00, kurse ankuesi përmes emailit të datës 17.04.2023 ka njoftuar se ftesën e dërguar në emailin zyrtar nuk e kam parë për shkak që ky email më është bllokuar, ndërsa ftesën në email privat e kam parë me vonesë, ndërsa ka konfirmuar që mund të paraqitet në seancë më datë 18.04.2023 nga ora 15:00 e tutje ose në një datë tjetër, kurse seanca e përcaktuar në këtë kohë është konfirmuar edhe nga Burimet Njerëzore të MPJD, si rrjedhojë më datë 18.04.2023 është mbajtur seanca e Komisionit Disiplinor me ankuesin.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes emailit të datës 31.03.2023 ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës mundësisht një raport lidhur me implikimin e ankuesit në rastin e lejimit hyrjes së derivateve në Republikën e Kosovës nga Serbia, ndërsa përgjigja nga Dogana e Kosovës i është dhënë më datë 26.04.2023, andaj referuar çështjes së potencuar më lartë Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme më datë 18.04.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.ref:118/2023 me të cilin ka bërë shtyrjen e afatit të procedurës administrative deri më datë 03.05.2023, si rrjedhojë marr parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat ky vendim është në pajtim me nenin 98 paragrafi 1, nenin 99 paragrafi 1,2 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që Vendimi me Nr.ref:160/2023 i datës 03.05.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është nxjerr brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit se Komisioni Disiplinor gabimisht ka konstatuar që nuk janë përmbushur detyrat e përcaktuara me vendimin e datës 24.10.2022 për shkak se kam përmbushur të gjitha detyrat e përcaktuar sipas këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi sipas Vendimit me Nr.Ref:360/2020 të datës 24.10.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është caktuar kryesues i grupit

ndërinstitucional për koordinimin e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare, si rezultat i kësaj, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 31.01.2023 i ka kërkuar ankuesit përmes emailit të përgatitet dosja për sanksione ndaj ".....", siç u kemi përcjell javë më parë, dhe njëherit i ka kërkuar që të njoftohet se deri ku jeni lidhur me përgatitjen e dosjes, ndërsa ankuesi përmes emailit të datës 01.02.2023 ka njoftuar Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës se do të kërkoj nga Departamenti Ligjor përgatitjen e propozim vendimit... duke i kërkuar nëse ka ndonjë datë të saktë se kur ju duhen, ndërsa zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes emailit të datës 01.02.2023 ankuesit i ka shkruar vetëm OK. Bazuar në këtë Kolegji i Këshillit, konstaton se Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk ka kërkuar nga ankuesi ndonjë datë konkrete se kur duhet të përgatiten sanksionet lidhur me rastin konkret dhe po ashtu nuk ka dhënë ndonjë afat lidhur me këtë çështje duke marr parasysh që procesi i sanksioneve është proces i vazhdueshëm, si rrjedhojë në këtë pikë nuk mund të konsiderohet mospërmbyshje e detyrave të punës për arsye se nuk është specifikuar saktë nga eprori koha e përfundimit të ndërmarrjes së veprimeve administrative sa i përket kësaj çështje.

Sa i përket çështjes së ndërhyrjes së ankuesit në punët e Doganave të Kosovës, Kolegji i Këshillit, nga provat e lëndës, konstaton se ankuesi më datë 06.03.2023 përmes emailit ka bërë komunikim me Zyrtarin e Doganave të Kosovës z.B.H (që njëherit është edhe anëtar i grupit ndërinstitucional për koordinimin e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare të emëruar sipas Vendimit me Nr.Ref:360/2020 të datës 24.10.2022), pa dijeninë dhe pa njoftuar fare Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, duke kërkuar sqarime lidhur me kompaninë e derivateve ".....", duke kërkuar ndër të tjera se a duhet të lejoheshin importimet e derivateve pasi që duhet ndalur vetëm nëse kanë pronësi 50%, sepse kemi një ankues i cili ka shpjegime nga Kroacia se në bazë të vendimeve të BE-së duhet ndaluar importimi vetëm nëse ka pronësi ruse mbi 50%, ndërsa zyrtari i doganave ka njoftuar që sanksionet në derivate kanë hy në fuqi më datë 05.02.2023. Si rrjedhojë e kësaj, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes emailit të datës 20.03.2023 ka kërkuar nga ankuesi se mbi cilën bazë dhe për çfarë arsye i keni parashtruar këto kërkesa drejtuar Doganës së Kosovës ndërsa ankuesi në të njëjtën ditë ka njoftuar se kërkesa e tij ka qenë në takim me të, pra takim që me ka kërkuar dhe ma ka shpjeguar kërkesën, kurse Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 31.03.2023 ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës nëse është e mundur të dërgohet një raport i veçantë lidhur me implikimet e z. D.Th, me rastin e importimit të derivateve nga Serbia në Republikën e Kosovës dhe ndërlidhjen e tyre me sanksionet ndaj mallrave me prejardhje, origjinë dhe aksione nga kompanitë e Rusisë, kurse Udhëheqësi i Sektorit për Këshilla dhe Procedura në Doganën e Kosovës sipas emailit të datës 26.04.2023 ka njoftuar Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës se forma e kërkesës së z.Th në cilësinë e kryesuesit të grupit koordinues për monitorimin e zbatimit të masave kufizuese ndërkombëtare, drejtë zyrtareve të DK-së pa përfillur njohuritë e hierarkisë në MPJD dhe duke u referuar me kërkesë dhe dokumentet të afishuara në to, si të tilla nga DK rezulton se janë vlerësuar si të papërshtatshme dhe me elemente që mund të qonin në pasiguri juridike sa i përket mbikëqyrjes

dhe zbatimit të masave shtrënguese ndërkombëtare në përputhje me fushëveprimin e DK-së, e të cilat janë bërë në referencë të një kompanie importuese si ankuese...ndërsa sa i përket ndërhyrjes së ankuesit në punën e Doganave të Kosovës, sipas këtij emaili rezultoi se Udhëheqësi i Sektorit për Këshilla dhe Procedura në Doganën e Kosovës njofton se nga DK është konsideruar në dukje si veprim rreth mënyrës së zbatimit praktik të sanksioneve ndaj dërgesave respektive, importi i të cilave për shkak të transaksioneve të tërthorta do të mund të krijonte pasoja në të zbatuarit e sanksioneve tregtare ndaj entiteteve të caktuara ruse.

Kolegji i Këshillit, marr për bazë, komunikimet e lartcekura, dhe faktin se ankuesi në asnjë komunikim të tij përmes emailit nuk ka përfshirë dhe nuk ka njoftuar Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe me qenë se ankuesi është emëruar si kryesues i grupit ndër-institucional për koordinimin e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare të emëruar sipas Vendimit me Nr.Ref:360/2020 të datës 24.10.2022, ka qenë i obliguar që për çdo komunikim të bërë t'a përfshijë edhe Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe po ashtu çështjet që kanë të bëjnë me sanksione ndërkombëtare duhet të diskutohen në grupin e caktuar, mbi këtë bazë sipas Kolegjit të Këshillit, rezultoi fakti se ankuesi me këto veprime ka shmangur detyrimet ligjore të përcaktuara me menin 25 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike", nenin 26 paragrafi 1 dhe nenin 28 të këtij ligji, kështu që pretendimi i ankuesit sa i përket kësaj çështje është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se mos respektimi i orarit të punës nuk është shkelje e rëndë disiplinore por është shkelje e lehtë, si rrjedhojë Komisioni Disiplinor nuk ka pasur kompetencë të shqyrtoj këtë pretendim të inicuesit, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës, konstaton se ankuesi për mos respektim të orarit të punës për periudhën nga data 04.01.2023 deri më datë 17.01.2023 ka të shqiptuar një masë disiplinore për shkelje të lehta, respektivisht vërejtjen me Nr.Ref:11/2023 të datës 23.01.2023 nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Kolegji i Këshillit, bazuar në provat e lëndës dhe bazuar mbi këtë konstatim, konstaton se ankuesi më datë 24.01.2023 ka bërë hyrje në punë në orën 08:41, më datë 25.01.2023 ka bërë hyrje më datë 08:30, më datë 26.01.2023 ka bërë hyrje në orën 08:21, më datë 27.01.2023 ka bërë hyrje në orën 08:24, më datë 31.01.2023 ka bërë hyrje në orën 08:51, më datë 06.02.2023 ka bërë hyrje në orën 08:25, më datë 08.02.2023 nuk ka bërë hyrje, më datë 09.02.2023 ka bërë hyrje në orën 08:35, më datën 10.02.2023 ka bërë hyrje në orën 08:22, më datë 13.02.2023 ka bërë hyrje në orën 08:36, më datë 14.02.2023 ka bërë hyrje në orën 08:42, më datë 15.02.2023 ka bërë hyrje në orën 08:31 dhe më datë 20.02.2023 ka bërë hyrje në orën 08:43, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit ju referua Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, gjegjësisht nenit 4 paragrafi 2, ku përcaktohet se: "Orari i punës së zyrtarëve publik fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00, pesë (5) ditë në javë duke

filluar nga e hëna deri të premten përveç nëse caktohet ndryshe nga institucioni përkatës për shkak të natyrës së punës”, si rezultat i kësaj, ankuesi pa ndonjë arsytim nuk ka respektuar orarin e tij të punës duke mos respektuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë respektivisht nenin 9 paragrafi 1, 2, 3 dhe 5, i cili përcakton se: “1. Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë prezent në vendin e punës. 2. Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni. 3. Mosregjistrimi në librat e vijueshmërisë në punë apo në regjistrin elektronik, llogaritet si mosprezencë në punë. 5. Mos respektimi i orarit të punës, sipas Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik paraqet shkelje disiplinore”, ngase me veprimet e tij ankuesi ka bërë shkelje të nenit 28 të Ligjit Nr. 06/L-1114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij”. Kështu që Kolegji i Këshillit duke marr parasysh që ankuesi për mos respektim të orarit të punës ka pasur të shqiptuar një masë disiplinore të shqiptuar dhe përkundër kësaj ankuesi ka vazhduar me mos respektimin e orarit të punës pa ndonjë arsye, kjo sipas Kolegjit konsiderohet shkelje e përsëritur e që përbën shkelje të rënda disiplinore në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar.

Andaj, Kolegji i Këshillit, lidhur me ligjshmërinë e Vendimit me Nr. ref: 160/2023 të datës 03.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, konstaton se Komisioni Disiplinor lidhur me rastin konkret të ankuesit ka arritur të konstatoj në mënyrë të drejtë shkeljen e bërë nga ankuesi duke bërë kualifikimin e drejtë të saj, mirëpo ky komision nuk ka arritur të argumentoj në mënyrë të drejtë pasojat e shkaktuara nga veprimi i ankuesit, si dhe duke marr parasysh faktin që ankuesi nuk ka përsëritur asnjëherë shkeljen e tillë respektivisht mos përmbushjen e detyrave të punës në kuptim të nenit 45 dhe nenit 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si rrjedhojë masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit nuk është në raport të drejtë me shkeljen në kuptim të nenit 50 paragrafi 2 të këtij ligji, si rrjedhojë është shqiptuar në kundërshtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nga se nuk janë konsumuar elementet e mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e masës më të rëndë disiplinore andaj nga ky konstatim, dhe meqë nga ajo që u konfirmue në pjesën e epërme të këtij arsyetimi se ankuesi ka kryer shkelje të rënda disiplinore për disa veprime që ngarkohej me vendim të komisionit disiplinor, atëherë Kolegji i Këshillit, në kuptim të nenit 18 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndryshon Vendimin me Nr.ref: 160/2023 të datës 03.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në raport me masën disiplinore, ashtu që masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil” ndryshohet në masën disiplinore “Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë për dy vjet”, kështu që me qenë se është trajtuar çdo pretendim ankimor, kolegji konstaton se pretendimi i ankuesit lidhur me shqiptimin e masës disiplinore është pjesërisht i bazuar andaj edhe u vendosë si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për



Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.764/2023, datë 26/06/2023

**Avdyll BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

